



**AUTORITETI KOMBËTAR
PËR SIGURINË KIBERNETIKE**

**Dobësi Denial-of-Service në Palo Alto Networks PAN-OS Advanced DNS
Security**

Data: 12/02/2026
Version: 1.0

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	1
Informacione Teknike	1
Rekomandime	1
Referenca	2

Përmbledhje Ekzekutive

Është identifikuar një dobësi DoS në funksionin **Advanced DNS Security (ADNS)** të Palo Alto Networks PAN-OS.

Dobësia i lejon një sulmuesi të paautentikuar nga distanca të dërgojë një paketë të formuar posaçërisht që mund të shkaktojë rindezjen e firewall-it. Përpyekjet e përsëritura të shfrytëzimit mund ta detyrojnë firewall-in të kalojë në **maintenance mode**, duke shkaktuar ndërprerje të zgjatur të shërbimit.

Informacione Teknike

Detaje të Dobësisë:

- **CVE-2026-0229**
- **CVSS V4 8.7 – High**
- Dobësia në PAN-OS Advanced DNS Security (ADNS) rrjedh nga trajtimi i pasaktë i kushteve të pazakonta ose të jashtëzakonshme (CWE-754).
- Një sulmues i paautentikuar mund ta shfrytëzojë këtë çështje duke dërguar paketa rrjeti të formuara keqdashës drejt një firewall-i me ADNS të aktivizuar. Shfrytëzimi me sukses mund të:
 - Shkaktojë rindezje të sistemit
 - Shkaktojë rindezje të përsëritura
 - Detyrojë firewall-in të hyjë në maintenance mode
 - Ndërpresë zbatimin e politikave të sigurisë së rrjetit

Versionet e Prekura

- PAN-OS 12.1 – versionet më të hershme se 12.1.4
- PAN-OS 11.2 – versionet më të hershme se 11.2.10

Versionet e Rregulluara

- PAN-OS 12.1.4 dhe më të reja
- PAN-OS 11.2.10 dhe më të reja

Rekomandime

Rekomandohet përditësimi i versioneve të prekura në versionet e rregulluara ose në versionet më të fundit të publikuara nga Palo Alto Networks.

Referenca

<https://www.tenable.com/cve/CVE-2026-0229>